

## Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës

### - një akademi e edukimit dhe zhvillimit të sigurisë publike

Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK) u themelua nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në shtator të vitit 1999. Qëllimi ishte formimi i një force moderne policore, që do ta krijonte besimin në zbatimin e ligjit dhe aplikoi në mënyrë efektive principet e policisë në bashkësi.

#### Hasan Sopa, OSBE

Deri më sot, ky institucion ka ofruar edukim dhe trajnim për më tepër se 7000 zyrtarë policor. Nëse kemi parasysh se filloi të punoi në një kohë kur pak institucione të tjera ishin themeluar, lirisht mund të konsiderohet si ndër institucionet më të suksesshmet në Kosovën e pasluftës. Pa dyshim, ky është një atribut i OSBE-së në përpjekje të ndërtimit dhe forcimit të institucioneve vendore.

#### Ne filluam nga zero

Sipas Steve Bennett, drejtor i shkollës që nga themelimi, shkolla e SHPK-së ka filluar të punoj jo më shumë se me një grup njerëzish nga stafi lokal dhe ndërkombëtar, të cilët ishin të përkushtuar dhe me një vizion. Me kohë u shëndrrua në një institucion të suksesshëm arsimor dhe profesional. "Nevojitej një institucion i përcaktuar me praktika, protokole, shërbime, me një program arsimor dhe me një numër aktivitetesh përcjellëse, për ta përm-bushur mandatin tonë", thotë Bennett.



Pritet që deri nga fundi i vitit 2005 të diplomojnë më se 7,500 kadet në Shkollën e SHPK-së.

#### NË KËTË NUMËR

Policia në bashkësi fq. 5-6

Femrat në SHPK një realitet fq. 6

Luftimi i krimit dhe raportimi në media pg. 9-10

Aktivitetet nga terreni pg. 11-12



"OSBE-ja si organizatë është përkushtuar seriozisht në përmirësimin e kushteve, përfshirë këtu edhe investimet në renovimin e shkollës për ta bërë shkollën një realitet dhe të përshtatshme për trajnim. Kjo nënkupton se Këshilli i Përhershëm i OSBE-së dhe udhëheqja e Misionit, që nga fillimi kanë marrë përsipër mandatin për trajnimin dhe zhvillimin profesional të policisë", shpjegon ai.


Sipas tij, përkushtimi i misionit dhe investimet patën një ndikim pozitiv jo vetëm te studentët dhe stafi i punësuar, por edhe në ekzekutimin e këtij programi. "Unë kam qenë i impresionuar me mundësinë e shteteve anëtare të OSBE-së, me Misionin dhe personelin e sekretariatit, për dërgimn e njerëzve kompetent në lëmi përkatëse. Prandaj, me mburrje mund të them se të gjithë ata që kanë ardhur për të punuar dhe ndihmuar zhvillimin e policisë, janë profesionist të kualitetit të lartë dhe një fortësi e dukshme e karakterit dhe forcës së OSBE-së si një organizatë regjionale".

Edhe pse përkushtimi dhe investimi i OSBE-së në shkollë është i rëndësishëm, bazuar në rezultatet e arritura, sipas z. Bennett, është e rëndësishme të pranohet roli individual i zyrtarëve policor të SHPK-së që kanë patur në këto rezultate. "Pa marrë parasysh se sa është e mirë shkolla apo sa të përkushtuar janë instruktorët tuaj, nëse nuk keni njerëz me integritet dhe aftësi themelore, dëshirë dhe vullnet për të mësuar, nuk mund të arrihen rezultatet".

#### Shkolla e SHPK-së model i edukimit profesional

Shkolla e SHPK-së, gradualisht është shëndrruar në një institucion që paraqet një model të mirë për edukim dhe zhvillim profesional të personelit për ruajtjen e rendit.

"Në një perudhë relativisht të shkurtë, ne kemi arritur të përgatisim njerëz shumë të



**Nikola Gaon**  
Zyrtar për informim publik,  
Misioni i OSBE-së në Kosovë

## Të dashur lexues,

Ky numër i Detajeve i dedikohet kryesisht aspekteve të ndryshme policore në Kosovë. I adresohet të ardhmës së Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës, proporcioni gjinor në strukturat policore, koncepteve të policisë në bashkësi dhe sigurisë publike, si dhe marrëdhënieve të policisë me media.

Derisa shumë njerëz në Kosovë, shpesh harrojnë se Misioni i OSBE-së, është ai i cili i ka trajnuar forcat policore në Kosovë që nga viti 1999 dhe është ende duke ofruar trajnime themelore dhe të avansuara deri në gradën e Kolonelit, ka edhe disa që nuk e dijnë as kuptimin e shkurtesës OSBE.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) simboizon organizatën më të madhe për të drejtat e njeriut dhe sigurinë e njeriut në regjionin e saj - prej Vankuverit e deri në Vladivostok. Së bashku me 55 shtetet anëtare nga Evropa, Azia Qendrore, Kaukazi, Amerika Veriore dhe nëntë partnerët për bashkëpunim, shtete nga Lindja e Mesme dhe e Afërt, OSBE-ja punon në segmentet humane, politike, të sigurisë, si dhe ato ekonomiko-ambientale. Ajo i zhvillon 18 operacione në terren dhe ndër to Misioni në Kosovë është më i madhi.

Në dhjetor të vitit 2001, shtetet anëtare e shpallën qëllimin e tyre që të përforcojnë të gjitha aktivitetet e Organizatës që kanë të bëjnë me polici. Njësia për Çështje Strategjike Policore (NÇSP) u themelua nën Sekretariatit e OSBE-së në Vjenë. Ajo formoi një rrjet të këshilltarëve policor në strukturën e Organizatës dhe tani është bërë një qendër e njohur.

Richard Monk, këshilltar i lartë për polici pranë OSBE-së dhe udhëheqës i NÇSP-së, ka

vërejtur në disa raste se stabiliteti ekonomik, politik, apo ekonomik nuk mund të arrihet pa përforcimin e ligjit dhe pa respektimin e institucionit për sundimin e ligjit. Ai shtoi se, "OSBE-ja ka përvojë të mjaftueshme për t'u marrë me të. Ne kemi një prani të madhe në terren, ndikim institucional dhe një numër të madh të shteteve që do të ofronin një angazhim afatgjatë nëse ka nevojë".

Deklaratat e tij janë fuqimisht të bazuara në Misionin siç është ky i Kosovës, si dhe në vullnetin e Këshillit të Përhershëm të OSBE-së për të marrë vendime kur ato nëvojiten.

Pas vendimit të Këshillit të Përhershëm për të vendosë Misionin e OSBE-së në Kosovë në vitin 1999, menjëherë pas përfundimit të konfliktit, OSBE-ja ndëmorri aktivitetet për trajnimin dhe zhvillimin e policisë. Misioni e rithemloi dhe rinovoi Akademinë Policore në Vushtrri, e cila tani quhet Shkolla e Shërbimit Policor në Kosovë (SHSHPK), si dhe aktivizoi një ekip i cili vazhdimisht u rrit, duke përfshirë mbi 260 trajnues ndërkombëtarë të policisë dhe 260 kuadro lokale, që punuan për krijimin e një force të re demokratike të policisë.

Që nga viti 1999, afro 7000 policë të ri kanë diplomuar në Shkollën e SHPK-së, kurse rreth 900 kanë ndjekur trajnime të avansuara si dhe janë graduar nga grada Rreshter deri në Kolonel. Kjo statistikë befasuese nënkupton që secili polic me të cilën dikush mund të kontaktojë ose ta shohë në Kosovë është trajnuar nga OSBE-ja.

Përfshirja e OSBE-së në çështje të policisë në Evropën jug-lindore nuk përfundon në Kosovë. Trajnimet e saj policore si dhe aktivitetet zhvillimore janë bërë edhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kroaci, Serbinë jugore dhe Mal të Zi. Në të gjitha këto vende, OSBE-ja ka dhënë ndihmë për modernizimin dhe ndërtimin e një force policore shumëtrike që përkrahë respektimin e të drejtave të njeriut. E përbashkëta e këtyre tri aktivitetëve ka qenë prezantimi dhe përkrahja e konceptit të policisë në bashkësi, që është duke u jetësuar edhe në Kosovë.

Me qëllim që të ilustrojmë madhësinë e operacioneve policore, ne do të përmendim se OSBE-ja ka ndihmuar në IRJM trajnimin e më shumë se 1000 rekrutëve për të siguruarë strukturën shumëtrike të policisë si dhe implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Nga përvoja e fituar në Evropën jug-lindore, OSBE-ja ka udhëhequr edhe një numër aktivitetesh të ngjashme në disa shtete të ish-Bashkimit Sovjetik; në Kirgizstan, Armeni, Tagjekistan dhe Azerbejgjan. Në bashkëpunim me Akademitë Policore të këtyre vendeve, OSBE-ja ka ndihmuar trajnimin e rekrutëve, ka ofruar kurse që zyrtarët policor t'i avansojnë aftësitë e tyre, si dhe është duke e ndihmuar zhvillimin e

tërsishëm të forcës policore duke e furnizuar me informata dhe sisteme komunikuese dhe trajnimet e nevojshme teknike.

Me tërë këto aktivitete, OSBE-ja është duke ndihmuar zhvillimin e demokracive që përkrahin sundimin e ligjit, por ajo është duke e ndihmuar edhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal për luftimin e krimit të organizuar.

Sipas z. Monk, kriminelit veq janë duke bashkëpunuar ndërkombëtarisht, prandaj qeveritë duhet të punojnë së bashku që t'i ndalojnë ata. Ai thotë se nëse ndonjë shteti i mungon kontrolli i brendshëm dhe nëse ai është lënë i pakontrolluar, atëherë ai shtet mund të bëhet kërcënim për të gjithë regjionin. "Është e rëndësishme që bashkësia ndërkombëtare të bashkohet dhe të godet këtë fatëkeqësi moderne. Në këtë kontekst OSBE-ja është e gatshme të angazhohet në këtë drejtim".

OSBE-ja do të vazhdojë ta luaj rolin e saj për arsimimin dhe zhvillimin e policisë. Në anën tjetër, Kosova mund të mburret që ka fituar vëmendjen e OSBE-së si dhe organizatave të tjera që janë duke e ndihmuar atë të zhvilloj organet e saj ligjore si dhe institucionet për sundimin e ligjit me qëllim që ajo të jetë më afër familjes evropiane.

## DETAJE

Gazetë e publikuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë

OSCE HQ, 10000 Prishtinë / Priština, Kosovo  
Tel: +381 38 500 162, Fax: +381 38 500 188

E-mail: [press.omik@osce.org](mailto:press.omik@osce.org)  
Web site: [www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo)

Botuesi:  
Sven Lindholm

Kryeredaktor:  
Nikola Gaon

Redaktorë:  
Hasan Sopa, (Detaje)  
Slaviša Mladenović (Detalji)

Faqesja:  
Shpend Kada

Bashkëpunorët:  
Edita Buçaj, Frank Harris, William Henley,  
Rexhep Krasniqi, Fatime Lepaja, Nderim Pasuli,  
Halide Sadiku, Mevlude Salihu, Ardiana Sejdiu,  
Mustafa Skenderi, Ardian Spahiu  
Vasilija Stanić,

**osce**  
Mission in Kosovo


Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

Ambasadori Werner Wnendt, shef i ri i Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së për ndërtim të institucioneve, si prioritet të tij ka vënë zhvillimin e Kosovës ashtu që të konsiderohet si shtëpi e të gjithë atyre që dëshirojnë të jetojnë sëbashku në paqë me fqinjët e tyre.

Ai vlerëson lartë progresin e arritur në trajnimin dhe edukimin e policies, por thekson se kërkohen përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të Shërbimit Policor të Kosovës, si një institucion demokratik që bazohet në respektimin e të drejtave të njeriur.

Gjatë visitës së tij Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës ia theksoj: "Jamë i kënaqur kur shoh se institucioni për trajnimin e zyrtarëve policor funksionon mirë dhe se mund të krahasohet me instituconet e vendeve përendimore. Fondi i përbashkët i OSBE-së dhe buxheti i konsoliduar i Kosovës mund ta lehtësoj procesin e dorzimit të përgjegjësishë Shkollës së SHPK-së".



**vijon nga fq. 1**

aftë dhe lirisht mund ta krahasoj SHPK-në me ciliëndo institucion policor modern në botë", thotë Bennett. "E vetmja gjë që u mungon atyre është përvoja, dhe sigurisht se nuk do të doja ta nënçmoja përvojën në vite për këtë lloj pune. Prandaj, mendoj se ata kanë arritur shumë më tepër se sa që kam pritur kur kemi filluar", shton ai.

**Mungesë në aftësi drejtuese**

Kur është fjala te bartja e përgjegjësishë, z. Bennett beson se sa i përket nivelit të operimit, zyrtarët policor të SHPK-së e dijnë se çka duhet bërë. Por ai mendon se për të pasur sukses në efektshmëri duhet pasur një përvojë të kosiderueshme. "Janë disa gjëra ku kërkohet shkathhtësi dhe përvojë e vecantë për të qenë me përgjegjësi të plotë. Meqë pjesa dërmuese e zyrtarëve policor kanë më pak se pesë vite përvojë pune, nuk mund të pritet një përfeksionim i shkathhtësive në një fazë kaq të hershme të zhvillimit, por ata çdo ditë e më tepër po i ofrohen marrjes së kompetencave të plota".

Sa i përket mandatit, Bennett mendon se Shkolla e SHPK-së duhet gjithësesi të vazhdojë në zhvillimin e kompetencave të SHPK-së sikurse edhe ka bërë gjatë viteve të fundit, me ofrimin e trajnimit themelor dhe duke vazhduar me përvojën në teren, ofrimin e kurseve të specializuara dhe duke e ndihmuar zhvillimin organizativ. "Me transferimin gradual të kompetencave, pritet që në vjeshtën e vitit 2005, do të ket progres në themelimin e ministrive të cilat eventualisht do të jenë në gjendje t'i marrin përgjegjësitë në drejtësi dhe zbatim të ligjit", thotë Bennett.

Sipas tij, sëpari duhet të identifikohen dhe përcaktohen rolet kryesore të ministrive. Mandej, ato duhet të ndihmohen në ngritjen profesionale me qëllim të avansimit të kompetencave. "Unë personalisht mendoj se kjo është një fushë me rëndësi ku përvoja dhe mandati i OSBE-së i përgjigjen në mënyrë të vecantë kësaj detyre. Mendoj se ne ende jemi organizata më kompetente për këtë mandat. Ky nuk është një mandat ekskluziv, sigurisht që duhet nda, siç do të vendoset gjatë planifikimeve të ardhshme dhe dialogut diplomatik", shtoi Bennett.

**Shkolla e SHPK-së dhe SHPK-ja të punoj për popullin e Kosovës**

Steve Bennett beson se shkolla së bashku me SHPK-në do të ekzistojnë në të ardhmën dhe do të vazhdojnë të punojnë për të gjithë qytetarët e Kosovës. "Unë besoj se shkolla do të evoluoj në atë që kosovarët besojnë se është zgjidhja më e mirë për zhvillim dhe edukim në siguri publike. Për momentin, sikurse edhe gjatë pesë viteve të fundit, shkolla do të ofroj shërbime për një numër disiplinash në sistemin e sigurisë publike dhe mendoj se vlera e këtij modeli është e evidente kur shohim rezultatet".

Bennett mendon se siguria publike varet nga një sistem efektiv dhe i koordinuar për ofrimin e shërbimeve, dhe shkolla mundet dhe duhet të jetë një mekanizëm i hershëm dhe i qëndrueshëm për promovimin e kësaj filozofie. "Unë parashikoj se do të vazhdojmë të ecim drejt atij modeli, që unë do ta quaja një akademi e edukimit dhe zhvillimit të sigurisë publike", konkludon Bennett.

**Biografia:**

**Steve Bennett**

*Direktor i Departamentit për Edukimin dhe Zhvillimin e Policisë, Misioni i OSBE-së në Kosovë, ka mbi 40 vite përvojë pune në zbatimin e ligjit në SHBA por edhe jashtë. Ai ka filluar të punoi për OSBE-në më 1999 dhe pesë vitet e fundit ka qenë në pozitën e drejtorit të departamentit për edukimin dhe zhvillimin e policisë në Kosovë, dhe ende është në atë detyrë. Ai gjithashtu ka marrë pjesë në programet për zhvillim për ish republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbisë, Afganistanit, Irakut, and Jordanis. Më herët ka shërbye si drejtor i bordit të shtetit Oregon për standardet dhe trajnimin e policisë, dhe është ish kryetar shoqatës ndërkombëtare të drejtorëve për standarde të zbatimit të ligjit dhe trajnim. Ai ka diplomuar për kriminalistikë në universitaetin e Saint Edwardit në Austin, Texas, akademia kombëtare e FBI-së dhe universiteti veri-perëndimor, instituti për trafikim ku edhe ka marrë "Kreml Leadership Award"*



# Ligji për Shërbimin Policor të Kosovës

Ligji për Shërbimin Policor të Kosovës është afër kompletimit dhe do të nxierret në formë të Rregullores dhe Udhëzimit Administrativ përkatës gjatë javëve vijuese. Është produkt i bashkëpunimit dhe punës së palodhur të ekspertëve konsulentë, këshilltarëve teknikë dhe juristëve të IPVQ-së, UNMIK-ut, OSBE-së dhe organizatave tjera. Edhe pse është e pamundur të thuhet se çdo legjislacion mund të arrijë konsensus të plotë të të gjitha palëve me interes, përpjekje të mëdha janë bërë në procesin zhvillimor për të fituar përkrahjen për kornizën ligjore, e cila i përgjigjet nevojave të ardhshme të SHPK-së dhe çka është më me rëndësi, të popullit të Kosovës. Ligji për shërbimin policor do të krijojë një bazë të shëndoshë mbi të cilën SHPK-ja do të vazhdojë të zhvillohet si një paradigmë e policisë demokratike në regjion.

Frank Harris, ShShPK

## Ligji bazohet në principe të shëndosha

Shërbimi demokratik policor duhet të formohet sipas kornizës së shëndoshë ligjore që plotësisht përfshin principet e përgjegjësisë, transparencës dhe përkrahjes së komuniteteve. Pasi që Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) përgatitet për kalim përfundimtar të Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) dhe të autoriteti ekzekutiv për shërbimin policor në Kosovë, kërkon një kornizë të tillë ligjore. Ndryshe nga organizatat simotra në zonat e ish Jugosllavisë, SHPK-ja është organizatë plotësisht e re, e liruar nga shumë brenga me të cilat ballafaqohet një organizatë policore e cila duhet të kalojë procesin, shpesh here të dhimbshëm të reformës. Si rezultat i trashëgimisë komuniste dhe politizimit të policisë gjatë periudhës së konfliktit, forma dominuese e policisë në ish Jugosllavi ishte modeli 'centralist'. Kjo e fundit karakterizohet si organizatë tej mase e centralizuar, e politizuar, me përgjegjësi të vogël dhe mungesë të mirëbesimit publik.

## Një ligj që merr në konsideratë kërcënimet ndaj policisë demokratike

Edhe pse SHPK-ja momentalisht gëzon një nivel të lartë të besimit në publik, ajo do të jetë e ndijshme ndaj ndryshimeve të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt dëmtojnë imazhin publik të saj, nëse ajo nuk ka një kornizë të shëndoshë ligjore. Në mesin e strukturave ekzistuese të IPVQ-ve ka indikacione se centralizmi, politizimi dhe ndërhyrja politike, mund të paraqesin kërcënim ndaj vlerave demokratike të SHPK-së. Ligji për SHPK-në, duhet, jo vetëm të krijojë bazë ligjore për strukturat momentale dhe organizatat që dalin nga SHPK-ja, por gjithashtu duhet të përfshijë masat që i ruajnë vlerat e SHPK-së dhe e parandalonjë lëvizjen e saj të mëvonshme drejt modelit 'centralist'. Gëzon fakti se këto çështje dhe brenga janë marrë në konsiderim për zhvillimin e Ligjit për Polici dhe në një masë të lartë janë adresuar në mënyrë të duhur në legjislacionin e ri.

## Karakteristikat kryesore të legjislacionit

Është e pamundur që përmes këtij artikulli të bëhet një përmbledhje e detajzuar e të gjitha dispozitave të draft-Rregullores dhe Urdhërësës Administrative. Megjithatë, pjesa pasuese është një përmbledhje e karakteristikave kryesore të ligjit pasi që ato kanë të bëjnë me parimet e policisë demokratike, siç janë përgjegjësia, transparenca dhe fokusimi në komunitet.



Përgjegjësia – Ligji i ri e përqafon parimin e përgjegjësisë në disa aspekte të rëndësishme. Komisioneri i policisë duhet të përpilojë planin vjetor për shërbimin policor, i cili përcakton qëllimet kryesore për vitin e ardhshëm, si dhe të dhënat se si policia i ka kryer detyrat e saj vitin e mëparshëm. Kjo i'a mundëson opinionit publik të kuptoj se sa SHPK-ja mund t'iu përgjigjet brengave të komunitetit, dhe si shpenzohen paratë e tatimpaguesve.

Sipas ligji besimi i popullit në polici bazohet në të qenurit e saj si organizatë jopolitike. Ai paraqet masat që parandalonjë pjesëtarët e policisë të jenë të angazhuar në mënyrë aktive në parti politike, si dhe forma tjera ligjore që mëtojnë t'a parandalonjë SHPK-në të bëhet mjet i politikës.

Respektimi i të drejtave të njeriut është një pjesë jetike e ligjit për një shërbim policor demokratik dhe kjo adresohet qartazi në draft-Rregullore. Përdorimi i forcës nga ana e pjesëtarëve të policisë është një vakum serioz në dispozitat ekzistuese të ligjit të aplikueshëm. Mirëpo, rregullorja e plotëson këtë vakum me një dispozitë, e cila është përpiluar në mënyrë të kujdesshme dhe e cila definoi faktorët kufizues të cilët do t'i përdorëte gjykata (nëse ka nevojë) që të caktoj se a ishte përdorimi i forcës i asyeshëm në ato rrethana.

Transparenca – Në bazë të inspektimit të saj SHPK-ja ka pranuar parimet e transparencës sepse ajo ofron një sistem tërësisht objektiv për rekrutim dhe gradim, që është i bazuar tërësisht në merita. Sa i përket strukturës gjinore dhe etnike të pjesëtarëve të saj, SHPK-ja e reflekton shoqërinë të cilës i shërben. E tërë kjo është institucionizuar në ligj. Përveç kësaj, ligji paraqet edhe një mekanizëm mbikëqyrës të pavarur që njihet si Inspektoriati i

Policisë – një masë që parashikon problemet e mundshme që mund të ndodhin në të ardhmen. Inspektoriati do të ketë dy funksione kryesore. Së pari, ai do të jetë përgjegjës për deklaratat serioze për sjellje të keqe të pjesëtarëve të policisë të të gjitha gradave, përfshirë këtu edhe Komisionerin, gjë e cila e çon policinë drejt një sistemi ku zyrtarët policor mbikëqyren nga një organ i pavarur e jo nga policia. Së dyti, ai do të kryej një varg detyrash audituese, ku ka kompetenca të inspektoj dhe raportojoj për efektshmërinë dhe efikasitetin e SHPK-së në çdo nivel.

Si masë e mëtutjeshme për të fuqizuar transparencën, ligji paraqet një subjekt të pavarur, të njohur si funksionet e larta të policisë dhe komisioni disiplinor. Ky grup do të jetë përgjegjës për selektim të kandidatëve, për nivel të komisionerit dhe zëvendës komisionerit, si dhe dëgjimet gjyqësore që kanë të bëjnë me kundërvajtjeve serioze disiplinore dhe rekomandim të dënimeve.

Përqëndrimi në komunitete - Pjesa e pestë (V) e Rregullores ka të bëjë me policinë lokale dhe me dispozitat të cilat u lejojnë komunitetet lokale të marrin pjesë në formulimin dhe implementimin e planeve të policisë lokale. Ky është një tipar vital i policisë demokratike. Nga zyrtarët policor kërkohet që të konsultohen aktivisht me përfaqësuesit e komunitetit, për shqetësimet e tyre për sigurinë publike, dhe hapat që duhet ndërmarrë në atë drejtim.

## Sfidat me të cilat do ballafaqohet ky ligj

Natyrisht, ky ligj do të mbetet thjeshtë një dokument i pavlerë përderisa nuk implementohet nga zyrtarët e SHPK-së, në dobi të të gjitha komuniteteve të Kosovës. Nuk ka ndonjë dyshim se paraqitja e SHPK-së do të vazhdojë të mbetet një element i rëndësishëm në përpjekje për të shtyerë Kosovën drejt zgjidhjes së statusit përfundimtar. Sikur edhe në shumë vende tjera fqinje, policia mban një rol kyq në krijimin e një shoqërie të sigurtë dhe të qëndrueshme, ku të gjitha komunitetet mund të zhvillohen dhe të përparojnë në një bashkëjetesë paqësore. Legjislatura e re paraqet një kornizë të fuqishme për suksesin e SHPK-së, sikurse edhe kërkohet në këtë sfidë të madhe.

### Për autorin:

Frank Harris është Këshilltar për Planifikim pranë Zyrës së Drejtorit, Departamenti i OSBE-së për Edukimin dhe Zhvillimin e Policisë. Ka qenë plotësisht i angazhuar në grupet punuese të cilat kanë prodhuar draft Rreguloren dhe Udhëzimet Administrative përkatëse.

# Shërbimi Policor i bazuar në bashkësi dhe siguri

**“Shteti i mirëfilltë ligjor parasëgjithash nënkupton që secili qytetarë në Kosovë të ketë të drejtë të jetoj, punojë dhe të udhëtoj në një ambient të qetë dhe të sigurt. Një ambient i tillë kërkon jo vetëm një shërbim policor efektiv dhe gjyqësor të mirëfilltë, por mbi të gjitha kërkon një bashkëpunim aktiv të çdo qytetari të Kosovës”. – Plani për implementimin e standardëve në Kosovë.**

**Hasan Sopa, OSBE**

Edhe pse situata e përgjithshme e sigurisë vazhdimisht është përmirësuar brenda këtyre pesë viteve të fundit, qytetarët e Kosovës ende nuk janë të sigurt se Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) ka përvojën e duhur për t’iu qasur çështjeve kaq komplekse. Ata janë një shërbim policor i ri dhe ende ka për t’u bërë shumë, para marrjes së përgjegjësisë së plotë si shërbim policor.


Për të ndihmuar Kosovën të bëhet një vend i qetë dhe më i sigurt, në vitin 2003, Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK) e drjetuar nga OSBE-ja, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët vendorë dhe ndërkom-bëtarë, bëri implementimin e programit të parë; ‘Njësitë Vepruese për Sigurinë në Bashkësi’. Qëllimi i programit është zhvillimi i raporteve të reja dhe promovimin e atyre ekzistues në mes të komunitetit, përfaqësuesve komunal dhe shërbimit policor. Ky program ka krijuar forume të shumëfishta për pjesëmarrje dhe bashkëveprim dhe bazohet në principet e policisë në bashkësi: “Policia janë njerëzit dhe njerëzit janë policia”.

## Koncepti

Nën konceptin policia në bashkësi, shërbimi policor dhe qytetarët bashkëpunojnë për zgjidhjen e problemeve në komunitet që kanë të bëjnë me krimin dhe rendin shoqërorë. “Për arritjen e këtyre qëllimeve nevojitet një bashkëpunim i ngushtë në mes të policisë dhe njerëzve në bashkësi që respektojnë ligjin”, thotë Julie Fleming, koordinatore e policisë në bashkësi pran shkollës së SHPK-së në Vushtrri. “Bashkëpunimi në mes të policisë, njerëzve në bashkësi dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal me qëllim të uljes së krimit dhe ngritjes së shkallës së sigurisë, është esenca e policisë në bashkësi”, shpjegon ajo.

“Policia në bashkësi është një filozofi dhe strategji”, thotë Dr. Tamara Duffey, këshilltare për projekte të veçanta në shkollën e SHPK-së. “Kjo strategji ofron mundësi për policinë dhe njerëzit në komunitet të bashkëpunojnë për gjetjen e zgjidhjeve lokale për problemet lokale”, shton ajo.

Sipas Dr. Duffey, një qasje policore e orjentuara në të drejtat e njeriut, e përshkon tërë filozofinë e policisë në bashkësi dhe ka dy elemente vepruese: ndryshimin e metodave dhe praktikave të policisë, që ato të jenë më demokratike, dhe vënjen e raporteve të fuqishme bashkëpunimi në mes të policisë dhe qytetarëve. “Ky lloj bashkëpunimi i jep



*Nën konceptin e policisë në bashkësi policia ndërton raporte të afërta me popullatën lokale, veçanërisht me të rinjtë.*

komunitetit një mundësi më të madh në përcaktimin e prioritetëve të policisë dhe angazhon të gjithë në përpjekje për përmirësimin e kushteve të përgjithshme jetësore”, shprehet ajo.

## Siguria në bashkësi çështje e të gjithë partnerëve lokal

Në përgjithësi njerëzit mendojnë se siguria dhe mirëqenja janë çështje vetëm të policisë. Julie Fleming, mendon të kundërtën: “Të gjithë partnerët lokal duhet të angazhohen për sigurinë në komunitet”, thotë ajo. “Kur njerëzit involvohen ata në një farë mënyre ndihen pjesë e rrethit ku jetojnë”.

Në Kosovë nuk ka traditë të policisë në bashkësi. Përkundrazi, ekziston një trashëgimi mosbesimi dhe mungesë bashkëpunimi. Për

ta ndryshuar këtë, kërkohen një përpjekje afatgjata. Dr. Duffey shpjegon: “Është një proces kompleks i cili kërkon në qasje të duhur në të gjitha nivelet për kthimin e filozofisë në veprim. Kjo zakonisht ka të bëjë me pikëpamjet e njerëzve, të cilat në shumë raste me arësye kanë qenë frikësuese dhe mosbesuese ndaj policisë”.

Për ta ndryshuar formën e policisë tradicionale në polici në bashkësi nuk është aspak e lehtë. Ron Schwartz, drejtor i pensionuar për siguri publike në qytetin Oregon SHBA, dhe instruktor në shkollën e SHPK-së shpjegon: “Policia në bashkësi nuk është thjeshtë një njësi e policisë që patrullon në bashkësi, por është filozofi e bërjes së policisë. Kjo do të thotë se puna e policisë nuk përqëndrohet vetëm në reagim ndaj thirrjeve të rëndomta,

*vijon në fq. 6*

por një angazhim aktiv në zgjidhjen e problemeve në bashkësi”.

Teknologjia e avancuar dhe pajisjet moderne të policisë në SHBA mundësuan intervenimin e shpejtë dhe efikas në thirrjet për ndihmë të qetëtarëve, por nuk ndihmun aq në evitimin e problemeve. Në njëfarë mënyre policia u kthyen në ‘polic pa këmbë’ duke bërë gjiro me makinë në përgjigje të thirrjeve të rëndomta dhe duke bërë shumë pakë apo fare kontakt me qytetarët në bashkësi. Kjo ka ndikuar që efektet në drejtim të luftimit të krimit dhe ofrimin e sigurisë të jenë shumë të vogëla. “Rezultatet ishin minimale deri sa ne filluam ta involvojmë tërë komunitetin; shoqatat e biznesit, shkollat, të moshuarit, njësin e parqeve të qytetit, madje edhe gangsterët, dhe vetëm kjo sjelli ndryshim. Ne thjeshtë i tejkalonim në numër grupet që sillëshin në parqe, ku shisnin drogë apo i shqetësonin qytetarët. Prezenca jonë aty të angazhuar në projekte të ndryshme, ndikoj që ata ngadalë të largohen ngase nuk kishte më hapsirë për ta”, thotë Ron Schwartz.

### Strategjia për zgjidhjen e problemeve

Z. Schwartz dhe kolegja e tij nga SHBA-të Pamela Cournoyer, kryetare dhe ekzekutive e korporatës për udhëheqje në bashkësi dhe mbështetje në detyrë, kanë ardhur në Kosovë për ta ndihmuar shkollën e SHPK-së në forcimin e programit të njësiteve vepruese në bashkësi. Deri më sot, njësite prej 35 personash janë themeluar në tetë, dhe janë në proces të formimit edhe në katër komuna tjera të Kosovës.

Njësitet vepruese për siguri në bashkësi do të vazhdojnë punën e tyre për ta quar përpara filozofinë e policisë në bashkësi përmes aplikimit të formës preventive, partneritetit dhe strategjive për zgjidhjen e problemeve për t’i adresuar shqetësimet e identifikuar nga policia dhe qytetarët.

Sipas z. Schwartz, komunikimi në mes të policisë, përfaqësuesve të institucioneve dhe qytetarëve, kohën e fundit është shtuar në mënyrë të konsiderueshme. “Kjo është vetëm njëri prej përfitimeve të policisë në bashkësi”, thotë ai. “Që nga viti 2003, projekte konkrete për zgjidhjen e problemeve kanë zënë vend nëpër komuna të ndryshme duke ardesuar problemet e rinisë dhe drogës në shkolla, çështjet e gropimeve, sigursë në trafik, vjedhjet, qentë endacak, krimet kufitare e shumë projekte të tjera”.

Policia në bashkësi dhe programi i njësiteve vepruese për siguri në bashkësi kanë ofruar një mundësi të shkëlqyeshme për policinë, komunat dhe komunitetin në tërësi. Mirëpo, një progres më i madhë pritet të ndodhë në ditët në vijim, siq thekson edhe Pamela Cournoyer, “Njerëzit këtu janë të hapur dhe dëshirojnë të mësojnë dhe punojnë së bashku për të mirën e komunitetit të tyre”. Sipas saj, kjo është diçka që nuk mund ta shohesh në shtetin prej nga ajo vjen.

# Femrat në Shërbimin Policor të Kosovës një realitet

**Përfshirja e femrave në Shërbimin Policor të Kosovës ka qenë një nga sfidat më të mëdha me të cilat është ballafaquar Misioni i OSBE-së, Departamenti për Edukimin dhe Zhvillimin e Plocisë, që nga fillimi, kur për herë të parë ka hapur dyert e veta në shtator 1999.**

**Ardian Spahiu, ShShPK**

Duke pasur parasyshë mentalitetin patriarkal, që ende është prezent në Ballkan, nuk pritej që femrat në Kosovë do të interesoheshin t’i bashkangjiten Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) të sapoformuar. Realiteti tregoi ndryshe.

### Femrat në SHPK-së mund ta krenojnë detyrën po si kolegët e tyre mashkuj, madje edhe më mirë.

Femrat në Kosovë, si edhe çdokund tjetër në botën perëndimore, treguan se nuk ka detyrë apo përgjegjësi në shoqëri të cilën ato nuk do të mund ta pranonin. Në të vërtetë përvoja në Kosovë na mëson se femrat police të SHPK-së mund të jenë po aq të mira, madje edhe më të mira, në kryerjen e detyrave, krashi kolegëve të tyre mashkuj.

Është inkurajues fakti se të gjitha femrat kadete të SHPK-së, të cilat më vonë u bënë police të diplomuara, ishin të përkrahura fuqimisht nga familja, shokët, dhe shoqëria e tyre. Me fjalë të tjera, pas vitit 1999 pamja e femrave police duke patrulluar rrugëve të Kosovës, për shumë nga ne ishte një ëndërr e realizuar.

“Familja ime është shumë krenare për shkakun se unë jam bërë police dhe kam rastin t’i shërbej popullit të Kosovës. Unë jam shumë e lutur që kam rastin të dëshmoj se femrat e Kosovës mund të bëjnë një ndryshim të madh në përmirësimin e jetës së të gjithë Kosovarëve,” tha Arbresha Bajrami e cila shërben në stacionin policorë regional të Pejës dhe e cila është shpërblyer me medalën e parë për shpëtimin e jetës.

### Të gjithë nën një flamur

SHPK-ë është shumë krenare për përbërjen e saj shumetnike. Duke i u faleminderuar përpjekjeve dhe kontributit të pafund të OSBE-së dhe bashkësisë ndërkombëtar në përgjithësi,

sot kemi femra dhe mashkuj të të gjitha grupeve etnike që shërbejnë nën një flamur, flamurin e Shërbimit Policor të Kosovës.

Slađana Stojanović, instruktore e SHPK-së dhe nënë e dy fëmijëve, tha: “Jam shumë e lumtur që kam pasur mundësi të tregoj se femrat mund të bëjnë punë të vështira dhe me përgjegjësi në Kosovë dhe bëjnë ndryshime positive.”

Mund të themi se OSBE-ja ka kryer mandatin e vet sa i përket kësaj çështje. Prej 6,953 policëve të cilët diplomuan në programin për edukim dhe zhvillim të shkollës së SHPK-së, 15% janë femra që përfaqësojnë të gjitha grupet etnike në Kosovë.

Që nga 16 tetorit 1999, kur në shkollën e SHPK-së diplomoi klasa e parë me 176 rekrut, femrat police prezantuan në secilën klasë. Klasa e 30-të ka kryer programin bazë të edukimit më 4 qershor 2005, dhe në momentalisht SHPK-ka këtë përbërje etnike dhe gjinore:

<b>Shqiptarë të Kosovës</b>	84%
<b>Serb të Kosovës</b>	10%
<b>Të tjerë:</b>	6% (Rom të Kosovës, Turk, Goran, Boshnjak, dhe Sllav Musliman)
<b>Mashkuj</b>	85%
<b>Femra</b>	15%

*Departamenti për Edukim dhe Zhvillim të Plocisë është ngarkuar me zhvillimin dhe trajnimin e një shërbimi të ri policor që do të përkrah shtetin ligjorë dhe respektoj më shumë të drejtat e njeriut. Për më tepër, do të siguroi respektimin e barazisë gjinor në bazë të marrëveshjes dhe fuqishëm inkurajon femrat për t’u bashkuar këtij institucioni dhe të luaj rol in e vet në shoqëri.*



# Gjenerata e re e rekrutëve merr detyrat e patrollimit në Kosovë

William Henley, OSBE

Më shumë se 330 rekrutë të policisë, gjenerata e 29-të e kadetëve që do të kyçen në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK), tani janë të gatshëm t'i marrin certifikatat por edhe detyrat si policë plotësisht të përgatitur pas mbarimit të trajnimit fushor 20 javor.

Derisa shumica e shërbimeve policore moderne evropiane kishin shekuj të tërë për të evoluar dhe zhvilluar, Kosova ka pasur vetëm pesë vite për të zhvilluar forcën e saj policore profesionale. Të zgjedhur nga zyrtarë policor ndërkombëtarë të UNMIK-ut dhe SHPK-së, rekrutët e rinj trajnohen nga Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK), e udhëhequr nga Departamenti për Edukim dhe Zhvillim të Policisë, pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Duke shënuar fundin e shkollimit dhe trajnimit elementar gjashtë mujor, trajnimi i strukturuar fushor me policinë e UNMIK-ut i sfidon rekrutët të zbatojnë në praktikë atë që kanë mësuar teorikisht në Shkollën e SHPK-së në Vushtrri. Ndër shkathtësitë të cilat këta policë duhet t'i zotojnë përfshijnë detyrat themelore të patrollimit, përdorimi i armëve të zjarrit, ndihma e parë dhe kontrollimi i trafikut.

## Trajnimi fushor – përgatitje mentale dhe fizike

Gjatë trajnimit fushor, të diplomuarit e shkollës policore caktohen me trajnuesit e kursit fillestar fushor nga UNMIK-u dhe SHPK-ja, të cilët funksionojnë si mentorë dhe vlerësojnë punën e tyre të përgjithshme.

"Në fillim ka qenë e vështirë sepse nuk i kam ditur rregullat dhe procedurat, por me kalimin e kohës kam kuptuar se kam përparuar shumë," shpjegon Majlinda Sadiku, police e re nga klasa e 29-të e rekrutëve, e cila sapo ka përfunduar trajnimin fushor në Prishtinë. "Kemi pasur përkrahjen e zyrtarëve policor më të vjetër, të cilët na kanë ndihmuar në situata të ndryshme. Këshillat e tyre kanë rëndësi shumë të madhe sidomos kur është në pyetje komunikimi me popullatën. Kështu që, atë që e kemi mësuar në shkollë, e kemi zbatuar në praktikë por pa ndihmën e më të vjetërve nuk do të kishim mundur të arrijmë atë që e kemi arritur", thotë ajo.

Isa Gashi, një tjetër rekrut i ri, shton: "Kemi pasur ekupe të përbëra nga një polic me përvojë dhe dy ose tre policë të ri. Zyrtarët policor me përvojë janë munduar shumë që të na i mësojnë gjërat që ata i kishin mësuar më herët. Me ndihmën e tyre, ne kemi arritur të zbatojmë në praktikë mjaft mirë atë që kemi mësuar në shkollë."

Çështje themelore në trajnimin fushor është zbatimi i praktikave moderne dhe aplikimi i policisë në bashkësi gjatë kryerjes së detyrave të përditshme. Kjo përfshin zbatimin e ligjit në të mirë të të gjithëve, dhe të qenurit në shërbim të popullit pa paragjykimë, frikë apo

favorizim. Në këtë mënyrë, zyrtarët policor mësojnë se si të punojnë së bashku me komunitetin në bashkësi për të luftuar krimin dhe sjelljet antishoqërore.

"Pas përfundimit të pjesës praktike, ata bëhen ekspertë të fushave të ndryshme, kriminologjisë, patrollimit në komunitet, trafikut etj," shpjegon Refki Morina, zëdhënësi i SHPK-së. "Krejt kjo ndodh gradualisht, duke shkuar hap pas hapi, derisa të arrijnë nivelin ku ata mund të bëhen zyrtarë policor profesional në fusha të caktuara," shton ai.

Morina vlerëson lartë angazhimin e rekrutëve të rinj dhe arrijtet e SHPK-së në muajt dhe vitet e fundit. "Kjo gjeneratë e re e policëve është entuziaste dhe ka vullnet për të punuar."

Policët e SHPK-së që patrollojnë në Kosovë tani janë më të shumtë në numër se kolegët e tyre të UNMIK-ut. "Rreth 30 stacione policore janë transferuar, dhe tani menaxhohen nga vendorët," thotë Morina. "Një region i tërë si Gjilani, është pavarësuar dhe tani udhëhiqet nga pjestarët e SHPK-së. Sukseset e këtij regionit janë me të vërtetë të mëdha, posaçërisht pas transformimit të kompetencave. Vetëm në ditët e fundit janë kapur 15 kg heroinë, në vlerë prej gjysmë milioni euro," shtoi ai.

## Rekrutimi cilësor jep zyrtarë policor të mirë

Gjatë viteve të suksesshme, numri i rekrutëve të rinj është rritur vazhdimisht, duke përmirësuar kështu kapacitetin e policisë vendore për të marrë përgjegjësinë e plotë si shërbim policor në Kosovë.

Procedura përzgjedhëse është shumë e ashpër. Përkundër interesimit të madh, ku deri në gusht 1999 kanë aplikuar më shumë se 19,000 kandidatë, vetëm 176 kadetë janë zgjedhur kur Shkolla e SHPK-së është hapur për herë të parë në shtator të vitit 1999. Deri më sot janë zgjedhur 7,300 kandidatë për t'iu bashkuar radhëve të SHPK-së.

Përveç që duhet të jenë më të vjetër se 21 vjeç, në formë të shkëlqyer fizike dhe mendore, kandidatët zgjidhen bazuar në gatishmërinë e tyre për të punuar me pjestarë të etnive dhe religjioneve të ndryshme, meritat në shkollim, përkushtimin e tyre për të drejtat e njeriut, dhe forcën e karakterit të tyre të përgjithshëm moral.

Rëndësi i kushtohet nevojës për të krijuar një forcë policore vërtetë reprezentative. Nga 30 gjeneratat e para të policëve të rekrutuar, 10% kanë qenë nga komuniteti serb i Kosovës dhe 6% nga minoritetet tjera. Numri i femrave që trajnohen po përmirësohet gjithashtu, me më shumë se 70 femra në klasën e 29-të.

"SHPK-në e konsideroj si forcë policore e cila do t'i shërbejë popullit të Kosovës dhe e cila



*Me përfundimin e trajnimit fushor, rekrutët sprovohen me vënjën në praktikë të shkathtësive të reja të përfituara gjatë trajnimit.*

do të jetë e lidhur me qytetarë pa dallim etnie apo gjinie," shpjegon Morina. "Një forcë me të vërtetë demokratike e cila do të punojë në pajtim me ligjet e aplikueshme."

## Trajnimi i avansuar dhe specializimi

Përveç trajnimit fushor të detyrueshëm, një kulturë e mësimit të vazhdueshëm është duke u strukturuar në zhvillimin profesional të të gjithë zyrtarëve policor. Për të siguruar besimin e popullatës në polici gjatë viteve të ardhshme, policët e certifikuar identifikohen rregullisht për trajnime të avancuara në fushat si; hetime kriminalistike, mbikëqyrje dhe menaxhim.

Shkolla e SHPK-së ofron edhe trajnime të specializuara për krimin e organizuar, negociatat në rastet e marrjes se pengjeve, armë dhe taktika të veçanta, si dhe ofron trajnime për policinë kufitare dhe zyrtarë policor të qendrave korrektuese.

Duke krijuar një shërbim policor të shkathtë dhe profesional, Shkolla e SHPK-së përpiqet të kthejë besimin në strukturat dhe organet për zbatimin e ligjit. Kjo është një gjë kyçe në sigurimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm në mes të publikut të gjerë, përfshirë këtu edhe komunitetet e ndryshme, policinë në bashkësi, për krijimin e një shoqërie demokratike që i bindet ligjit dhe respekton të drejtat e njeriut.

Morina është optimist për të ardhmen. "Njerëzit në Kosovë nga të gjitha nacionalitetet kanë kuptuar se duhet të bashkëpunojnë me policinë e Kosovës sepse ne jemi në shërbim të tyre dhe ne i mbrojmë interesat e të gjithë banorëve të Kosovës."

Pas përfundimit të trajnimit fushor, sfida për këta policë të rinj është përmesja e këtyre standardeve të larta, gjë që pritet nga eprorët e tyre, trajnerët dhe populli në tërësi.

# OSBE-ja dërgon Ekspertë të të Drejtave të Njeriut në polici

Roli i policisë në një shoqëri moderne demokratike është të mbështesë të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, si dhe rendin dhe sigurinë publike. Kjo është ajo që qytetarët e rëndomtë presin nga policia, dhe në të njëjtën kohë është njëri ndër prioritetet e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Zaal Margvelashvili, OSBE



Ekspertët për të drejtat e njeriut ndihmojnë aktivitetet e policisë të jenë në përputhje me të drejtat e njeriut.

Në vitin 1999, Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) i është dhënë përgjegjësia për detyrat dhe aktivitetet policore në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së. Kështu, një forcë policore (Policia e UNMIK-ut) u vendos në Kosovë dhe paralelisht filloi zhvillimi i Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK-së).

Në fazën fillestare, të gjitha funksionet e policisë janë kryer nga Policia ndërkombëtare e UNMIK-ut; policët e SHPK-së vetëm kanë ndihmuar dhe përfituar nga përvoja e zyrtarëve policor ndërkombëtarë. Me kalimin e kohës, roli dhe funksioni i SHPK-së është shtuar gradualisht, kështu në vitin 2004 ka filluar transferimi i plotë i funksioneve policore nga Policia e UNMIK-ut në SHPK në

nivelin komunal dhe regional.

Misioni i OSBE-së ka ndjekur për së afërmi zhvillimet në lidhje me policinë, duke ndryshuar përqëndrimin e vet sipas ndryshimit të situatës në Kosovë. Që nga fillimi, Misioni ka monitoruar organet për zbatimin e ligjit dhe ka adresuar rastet specifike nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Më vonë, OSBE-ja ka marrë një qasje më tematike, ku janë përpiluar raporte të ndryshme për çështje të të drejtave të njeriut dhe i janë dorëzuar autoriteteve policore. Për të siguruar se ndikimi i tyre do të jetë afatgjatë, OSBE-ja ka fokusuar përpjekjet e saj në zhvillimin institucional të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shërbimin policor.

Në marrëveshje me udhëheqësinë e Policisë së UNMIK-ut, dhe pas nënshkrimit të përkrahimit të detyrave me SHPK-në, në janar të vitit 2005, misioni ka filluar implementimin e programit për Ekspertë të të Drejtave të Njeriut, i dizajnuar për të krijuar dhe nxitur një kulturë të të drejtave të njeriut brenda shërbimit policor.

Më pas, Misioni ka filluar të vendosë ekipe të Ekspertëve për të Drejtat e Njeriut (EDNJ) në stacionet kryesore të policisë në Prishtinë dhe në pesë zyrat regionale. Roli i tyre është të sigurojnë kalimin e ekspertizës së Misionit mbi të drejtat e njeriut në polici. Ekipet e këshillojnë SHPK-në dhe zyrtarët policor të UNMIK-ut në zhvillimin e politikave për të drejtat e njeriut dhe në të njëjtën kohë, ngrisin kapacitetet e zyrtarëve policor për të kryer detyrat e tyre në përputhje me të drejtat e njeriut. Kjo qasje e lejon OSBE-në të ndikojë në vendimarrjen e policisë në fazë të hershme, duke bërë ndryshime të qëndrueshme në afat të gjatë kohor.

EDNJ-të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarë policor në pozita të larta, profesionale dhe me zyrtarët policor të rinjë. Për të bashkëpunuar sa më mirë, këta ekspertë janë pjesë e zyreve të komandantëve të policisë, dhe e kryejnë punën e tyre nga ndërtesat e policisë.

Aktivitetet e Ekspertëve për të Drejtat e Njeriut përqëndrohen në fusha si: arrestimet dhe mbajtjet në paraburgim; të drejtat e personave të arrestuar siç janë personat e mitur, personat e sëmurë mentalisht, dhe ata që kanë nevojë për trajtim mjekësor; të drejtat e viktimave, posaçërisht viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit; transparencën dhe besimin e popullatës në polici, duke përfshirë ankesat e brendshme dhe pakujdesinë. Ata poashtu identifikojnë nevojat për ngritjen e kuadrove dhe e ndihmojnë policinë në organizimin e trajnimeve.

Implementimi i suksesshëm i programit varet shumë nga besimi i ndërsjellë në mes të zyrtarëve policor dhe Ekspertëve për të Drejtat e Njeriut, por edhe nga angazhimi i të gjitha palëve për ta kuptuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut si bazë dhe arsye për punën e tyre. OSBE-ja është e vendosur për të ndihmuar një proces të tillë. Duke u bazuar në bashkëpunim e deritashëm me SHPK-në, programi i EDNJ-së do të ketë rezultate të menjëhershme.



# Luftimi i krimit dhe raportimi në media

## Policia dhe gazetarët duhet të punojnë së bashku

Një nga lajmet më të rëndomtë është lajmi mbi krimin. Shfletu cilëndo gazete nacionale apo lokale dhe shiko ose dëgjo ndonjë lajm në televizion apo radio, cdo herë ka gjasa të shfaqet ndonjë lajm mbi krimin. Nëse ndonjë figurë publike akuzohet për aktivitet kriminal, kemi të bëjmë me skandal. Nëse ndonjë bandë sulmon dhe plaçkit kalimtarët në një qytet të caktuar, opinioni publik duhet të njoftohet paraprakisht.

William Henley, OSBE

Dosjet në polici dhe statistikave të krimit përbëjnë numrin më të madh të lajmeve mbi krimin. Për çfarëdo krimi policia duhet të jetë pika kryesore e kontaktit për secilin gazetarë hulumtues. Policia është ajo që duhet të përgjigjet dhe ta hetojë krimin. Ajo është për ta vlerësuar saktësinë e tregimit, t'i verifikojë burimet e informatave të gazetarëve dhe të siguroj detajet esenciale, siç janë rrethanat që e shoqërojnë krimin apo progresin në lidhje me hetimet policore. Të gjithë gazetarët dhe redaktorët e mirë e kanë të qartë se besueshmëria e gazetës, stacionit televiziv ose radios është vendimtare për suksesin e tyre. Nëse opinioni publik nuk mund të mbështetet në saktësinë e tregimeve të tyre, dëgjueshmëria apo tirazhi i mediave pa dyshim se do bie.

### Kontakti kryesor

Policia mund t'u ofrojnjë reporterëve qasje në vendin e krimit për të filmuar apo fotografuar, në mënyrë që t'u ofrojnjë redaktorëve ilustrime për t'i plotësuar fjalët e reporterit. Zyrtarët policor mund të japin intervista ekskluzive apo t'i lejojnë gazetarët të udhëtojnë me ta gjatë operacioneve apo përpjekjeve për arrestime duke u mundësuar reporterëve depërtim të thellë në vendin e krimit, dhe duke rritur me të madhe elementin e dramës në tregimin mbi krimin.

Për këtë arsye, kultivimi i kontakteve me zyrtarë policor për gazetarë ka rëndësi të madhe. Por, redaktorët duhet të kuptojnë se gazetarët e tyre nuk mund t'a ndërtojnë besimin me zyrtarë policor mbrenda nate. Ata duhet t'i lejojnë korrespondentët që raportojnë për krimin të specializohen. Claude Salhani, redaktor i 'United Press International', në një trajnim për gazetarë dhe zëdhënës të SHPK-së, të sponsoruar nga OSBE-ja, spjegoi: "Nëse policia ka besim në ju, nëse pini kafe apo edhe drekoni bashkë herë pas here, ai ose ajo do t'iu japë shumë më tepër informata jozyrtarisht, duke i'u ndihmuar me informatat, gjë që e bën punën tuaj si gazetarë shumë më të lehtë".

### Bashkëpunim i dobët

Sidoqoftë, në marsin e vitit 2004, u bë e qartë se niveli i bashkëpunimit të mediave të Kosovës me zyrtarë policor ishte larg nga të qenurit i kënaqshëm. Mediat e shkruara dhe ato elektronike u kritikuan ashpër



Bashkëpunimi në mes të policisë dhe gazetarëve është një proces i dyanshëm.

për raportimin e incidentit, që ndikoj në shkallëzimin e dhunës, mbyttja në lum e tre fëmijëve shqiptarë. Raporti i Komisionerit kritikoi ashpër "raportimin e pamatur dhe senzacional të 16 marsit, duke veçuar Radio Televizionin e Kosovës (RTK) dhe Kohavisionin (KTV) për "injorim me qëllim" të deklaratave të policisë së KB-së.

"Rreth orës 22:00 ne morrëm informatat nga burimet tona se disa shqiptarë nga rajoni ishin nisur drejt fshatit Çabër për të protestuar për vdekjen e fëmijëve", Tracy Becker, zëdhënese e policisë rajonale të UNMIK-ut, më vonë shpjegon ngjarjet e 16 marsit: "U ktheva prap në media, posaçërisht në RTK and KTV, dhe dhashë një intervistë para kamerave, gjatë së cilës unë u apelovala njerëzve të ruanin qetësinë dhe të qëndrojnë në shtëpi në mënyrë që policia të mund të koncentrohet në gjetjen e fëmijëve, në vend se të dërgojnë forca për t'u marrë me turmat e njerëzve."

"Unë përsëri theksova se ne nuk kemi pasur fakte t'i mbështesim thashethemet se serbët i kanë mbytur fëmijët shqiptarë. Unë kërkova nga RTK dhe KTV t'i transmetojnë pamjet në mënyrë që ta qetësojnë opinionin publik dhe t'i ulin tensionet etnike. Me sa e di unë, këto televizione nuk e transmetuan intervistën time," shton Becker.

### Mosbesimi dhe frika

Siç spjegon Alma Lama, gazetare në RTK: "Deri tash, marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe gazetarëve kanë qenë të varfëra. Mungesa e përgjithshme e besimit është arsyeja kryesore," thotë ajo. Natyrisht gazetarët e shohin qëllimin e tyre në shërbimin dhe informimin e opinionit publik, por qasja e thjeshtë është se policia don të ushtroj kontroll mbi informatën e cila nuk i lavdëron operacionet e tyre. Për gazetarë, mund të jetë e mundimshme t'i afrohen shumë afër policisë.

Nga ana tjetër, policia friksohet se duke u dhënë shumë detaje gazetarëve, mediat do të publikojnë apo transmetojnë informata kyçe që mund ta rrezikojnë një arrestim, t'iu ndihmojnë të dyshuarve të largohen apo t'i rrezikojnë policët hetues. Ata kuptojnë se gazetarët janë nën presion të vazhdueshëm nga ana e redaktorëve të tyre për të bërë tregime interesante. Zyrtarët policor frikohen se fjalët e tyre mund të merren jashtë kontekstit apo të manipulohen, me apo pa dashje, nga gazetarët dhe redaktorët të tej entuziazmuar. Raportimi i pamatur dhe i pa verifikuar i ngjarjeve të 16 marsit nuk ka bërë asgjë në drejtim të shtimit të besimit të policisë në media.

vijon në fq. 10

vijon nga fq. 9

Por, kujdesi i tepruar nga ana e policisë mund ta rrisë mosbesimin dhe shkaktoi neveri në mesin e gazetarëve. Edhe nëse policia u besojnë gazetarëve, ata mund t'i shikojnë si të bezdisshëm dhe të mërziqshëm, që ua largojnë vëmendjen nga puna e vërtetë policore. Në të vërtetë, mediat duhet të përdoren si mjet i vërtetë për luftimin e krimit.

### Media si mjet për luftimin e krimit

Një nga problemet më të shpeshta për policinë janë viktimat dhe dëshmitarët që nuk i raportojnë krimet. Kjo posaçërisht ka të bëjë me disa nga llojet më të fshehta të krimeve si trafikimin e njerëzve, korrupsionin, abuzimin në shtëpi, droga, etj. Frika për përbuzje nga opinioni publik, apo shqetësimi se policia nuk do t'i trajtojë deklaratat e tyre seriozisht, janë shkaktarët kryesorë për mosdashje të viktimave apo dëshmitarëve të raportojnë në polici. Por, duke u ndihmuar mediave në publikimin e tregimeve për krimin dhe duke i sjellur krimet e lartpërmendura tek vëmendja e publikut, viktimat dhe dëshmitarët mund të inkurajohen ta raportojnë krimin.

"Ta marrim si shembull dhunën në familje", spjegoi Refki Morina, zëdhënësi i Shërbimit Policor të Kosovës: "Gazetarët janë burim kryesorë në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve në lidhje me këto krime. Raportimi i tyre mbi këto raste i ka inkurajuar gjithnjë e më shumë viktimat të paraqiten në polici, posaçërisht në qytete, por edhe në zona rurale."

Me anë të publikimit të përshkrimeve dhe fotografive të të dyshuarve, apo apelit të policisë drejtuar publikut që të raportojnë

krimin, shtohen gjasat për kapjen e të dyshuarve. Ndonjëherë gazetarët janë të gatshëm të kontribuojnë me informata nga hetimet e tyre personale dhe janë të gatshëm të dëshmojnë në gjyq, duke ndihmuar në sigurimin e ndjekjes së suksesshme penale.

### Mbrojtja e publikut

Prioritet parisorë për policinë është mbrojtja e publikut. Nëse një mori vjedhjesh apo seri e sulmeve ndodhin në një pjesë të qytetit, policia do të dëshironte t'a paralajmërojë publikun për rrezikun. Për këtë arsye është në interesin e policisë t'i përdor mediat si një mjet për të kontaktuar me publikun, duke përdorur televizionin, radion apo mediat e shkruara për ta dhënë porosinë. Përveç sigurisë publike, mediat gjithashtu veprojnë si një mjet i shkëlqyeshëm për të nxjerr në pah tregimet e suksesshme policore duke raportuar për arrestimet dhe ndjekjet e suksesshme. Duke ngritur transparencën e policisë dhe duke u lejuar gazetarëve qasje më të madhe në polici, ndihmon në rritjen e besimit publik në sistemin e drejtësisë kriminale. Si pasojë, gjasat që qytetarët të marrin drejtësinë në duart e tyre, siç ndodhi në mars të vitit 2004, do të redukohen dukshëm.

Para një viti, disa gazetarëve dhe redaktorëve dështuan t'i kushtojnë vëmendje adekuate thirrjeve të policisë për qetësi. Ata dështuan në të qenurit objektiv dhe ishin të papërgjeshëm në raportimin e fakteve, duke dhënë rëndësi të tepruar shpjegimit spekulativ të ngjarjeve të atyre ditëve.

Siç tha Georgy Kakuk, zëdhënësi rajonal i UNMIK-ut, me rastin e shpjegimit të ngjarjeve

të 16 marsit: "Gjatë asaj nate dukej se gazetarët nuk mërziqeshin se çka thonim. Duket se ata kishin nxjerrë përfundimet e tyre në herët. Çdo gjë që ne thonim, nuk merrej në konsideratë."

### Përfitimet reciproke

Në fakt, ata do të duhej të kishin punuar bashkë me policinë. Në mënyrë që të korrin rezultate dhe të kenë përfitim nga bashkëpunimi, të dy palët duhet të bashkëpunojnë me një kulturë të mirëkuptimit dhe besimit.

Gazetarët dhe redaktorët duhet të kuptojnë se policia nuk mund t'i rrezikojë hetimet që janë duke vazhduar, të zbulojë dëshmitarët e rëndësishëm, apo të minojë të arriturat e drejtësisë dhe të të drejtave të njeriut. Gazetarët duhet ta pyesin vehten se a vlen që tregimi të botohet kur të krahasohet me dëmin që do t'i shkaktojë hetimeve policore apo druajtjes se do të shkaktojë dhunë të mëtejme duke rrezikuar sigurinë publike. Gazetarët duhet të jenë objektiv dhe të matur në tonin e tyre dhe para së gjithash ata duhet të jenë të saktë.

Gazetarët dhe redaktorët njësoj duhet të kenë durim dhe të presin njoftimin e plotë të policisë apo konferencën për shtyp në lidhje me rezultatet e hetimeve. Spekulimi apo 'hamendja' e gazetarëve, mund të jetë pjesë e hetimeve të tyre, por duhet rrallë të jetë pjesë e artikullit të botuar ose emisionit televiziv, përveç nëse është vërtetuar. Larg nga tradhtimi i principit të raportimit objektiv e të paanshëm, bashkëpunimi me polici mund ta ngrisë besueshmërinë e tregimit dhe si kompensim ta ngrisë tirazhin e gazetës ose besimin në medium.

### Proces i dyanshëm

Ky është sigurisht proces i dyanshëm. Në marrëveshje që të mos publikohet lajmi derisa të kryhen arrestimet kyçe, policia duhet t'u ofrojë gazetarëve ekskluzivitet, duke u siguruar intervista dhe citate që ta përmirësojnë kualitetin e lajmit. Zëdhënësit e policisë duhet të jenë të hapur dhe të ndershëm në lidhje me afatet e gazetarëve dhe ta kuptojnë presionin që e kanë gazetarët nga redaktorët e tyre, rivalët e tyre, nga rrethi i lexuesve apo publiku. Por, mbi të gjitha ata duhet të jenë mirënjohës për mundësinë e përdorimit të mediave për luftimin e krimit.

Dobia e bashkëpunimit është e qartë, për gazetarë dhe zyrtarë policor. Të punojnë së bashku nuk do të thotë tradhëti, si dhe nuk kufizon efikasitetin e punës së policisë dhe kualitetin e lajmit. Pa marrë parasysh se cilat janë objektivat, përmirësimi i raportimit, shtimi i tirazhit të gazetës apo ngritja e besimit të radios apo televizionit në publik, apo edhe të arrihet drejtësia dhe të sigurohet siguria publike, zyrtarët policor dhe mediat duhet ta kuptojnë se e vetmja mënyrë që të arrihet kjo, është që të dy palët të punojnë së bashku.



OSBE-ja ndihmon mediat dhe zyrtarët policor në ndërtimin e besimit të ndërsjellë.

# Shkolla e SHPK-së mbështet liderët e ardhshëm

Vushtrria është një qytet i vogël rreth 25km në perëndim të Prishtinës, kryeqytetit të Kosovës, por për forcën policore të Kosovës, shifra e të cilës tani arrin në 7,000 pjesëtarë, kryeqytet është Vushtrria.

**Edita Buçaj, OSBE**

Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK), e udhëhequr nga OSBE-ja, ndodhet në qendër të Vushtrrisë. Rregulli dhe pastërtia aty është mbresëlënëse, sikur që është edhe organizimi.

Policët nuk janë të vetmit që kanë pasur rastin dhe privilegjin të mësojnë këtu. Në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës trajnohen edhe të gjitha grupet e sigurisë publike, që përfshijnë punëtorët e sigurimit, qendrave korrektuese dhe doganave, si dhe zjarrëfikësit.

Por, objektivat janë zgjeruar dhe Shkolla e SHPK-së po kërkon mënyra për të ndërtuar ura me komunitetin, në veçanti me të rinjtë.

Pa dyshim, pjesa më e madhe e popullatës së Kosovës përbëhet nga të rinjtë, me përafërsisht 60% të popullatës nën moshën 30 vjeçare.

Pasi që elita politike nuk është shumë e pasur me politikanë të rinjtë, ka lindur ideja për të filluar një projekt i cili do të zhvillonte dhe forconte grupet rinore, dhe në të njëjtën kohë do të kontribuonte në themelimin e lidhjeve në mes tyre dhe policisë.

“Ne kemi filluar të organizojmë kampet rinore në vitin 2004. Kampi i parë është mbajtur në korrik dhe i dyti në nëntor,” thotë Nerimane Gërguri, njëra nga menaxheret e projektit të Kampeve Rinore në Shkollën e SHPK-së. “Kampi i tretë do të mbahet kah fundi i qershorit të vitit 2005 dhe numri i të rinjve që do ta ndjekin këtë kamp do të jetë 250. Ky numër është dyfishuar në krahasim me kampin e parë

dhe kjo është një gjë shumë inkurajuese.”

Duke prekur aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut, përgjegjësive qytetare, menaxhimin e konflikteve dhe zgjidhjen e tyre, këta të rinjë mësojnë shkathtësi të dobishme për t’u bërë liderë në një ambient të larmishëm siç është Kosova.

“Efekti i këtyre kampeve do të shihen më vonë, pasi që pjesëmarrësit janë të ri dhe akoma duhet të përfundojnë shkollën e mesme. Sidoqoftë, planprogrami i hartuar me profesionistët tanë paraqet një fillim shumë të mirë në kohën kur ata nisin t’i japin formë të ardhmes së tyre,” thotë Juliane Hertweck.

Zsh. Hertweck ka punuar me grupet rinore të Kosovës për një kohë të gjatë dhe është e bindur se nga puna e tyre do të kenë dobi nënësit, komunitetet prej nga vijnë ata por edhe policia.

“Kjo ka të bëjë edhe me ndryshimin e mënyrës së të menduarit. Nuk ka më arsye për frikë për t’iu afruar policisë dhe biseduar me ta, sepse policia është në shërbim të popullit,” shprehet ajo.

Këta të rinjë nga të gjitha grupet etnike të Kosovës, përveç mundësisë për ta njohur më mirë policinë dhe për t’u njoftuar me moshatarë nga rajone të ndryshme gjatë këtij kampi, do të zhvillojnë edhe besim dhe respekt të ndërsjellë.

“Kam takuar shumë moshatarë në këtë kamp dhe kemi kaluar me të vërtetë mirë me policë



Shkolla e SHPK-së kërko rrugë për ndërtimin e urave me komunitetet lokale.

dhe trajnues në Shkollë. Për shumicën nga ne, kjo ka qenë përvojë e parë e këtij lloji dhe i këshilloj të gjithë ata që kanë mundësi, të marrin pjesë në këto kampe,” tha një pjesëmarrës turk.

“Shkolla Policore do të vazhdojë të organizojë aktivitete të këtij lloji edhe në të ardhmën,” tha Steve Bennett, drejtor i Shkolës së SHPK-së. “Misioni i OSBE-së në Kosovë do të vazhdojë të përkrahë të rinjtë duke iu ofruar projekte të ndryshme edukative në mënyrë që ata të marrin vendin që e meritojnë në shoqëri,” shton Bennett.

## Aktivitetet kryesore nga terreni

**Nderim Pasuli, OSBE**

**Misioni i OSBE-së në Kosovo paraqet programet e veta përmes rrjetit të cilin e përbëjnë tetë zyre: në Gjilan, Lipjan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtërpçë; dhe selisë në Prishtinë.**

**Gazeta ‘Detaje’ me kryeartikuj të ri do të ofrojë të dhëna të detajuara për veçoritë e punës së zyreve të OSBE-së dhe gjithashtu do të ofrojë edhe shumë sqarime për projektet të cilat i drejtojnë.**

**Zyra e OSBE-së në Prizren është zgjedhur ndër të parat për punën e sajë me rini dhe minoritete etnike.**

### Puna me rini ka për qëllim ngritjen e njohurive për institucionet vendore dhe përgjegjësitë e tyre

Dy cikle të zgjedhjeve komunale janë mbajtur në Kosovë dhe tani autoritetet komunale janë funksionale. Mirëpo ende ka mungesë të njohurive, sidomos në mes të të rinjve, lidhur me strukturat komunale, funksionimin dhe përgjegjësitë e tyre.

Prandaj është e nevojshme të formohen lidhje të forta në mes të rinisë dhe institucioneve vendore në mënyrë që praktikat demokratike të bëhen traditë e Kosovës.

Zyra e OSBE-së në Prizren ka për qëllim vetëdijësimin e nxënësve lidhur me

strukturat komunale të Prizrenit dhe kompetencat e tyre me një fokusim të veçantë në obligimet e komunës ndaj qytetarëve dhe anasjelltas. Ka ndihmuar në themelimin dhe tani mbështetë aktivitetet e Përfaqësuesve të Rrjetit të Shkollës (PRrSh), një grup shumetnik me mbi 30 student të shkollave të mesme, të shoqëruar nga mësime të ndryshme të tyre, përfaqësojnë shkollat e mjekësisë, ekonomisë, teknologjisë, muzikës dhe gjimnazit.

Sipas Maurizio Giachero, nga zyra e OSBE-së, Përfaqësuesët e Rrjetit të Shkollës synojnë t’i japin shtytje aktiviteteve të rrjetit në mes të përfaqësuesëve të shkollave të ndryshme. “Kjo ka për qëllim edhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre për bashkëveprim me institucionet vendore,” tha ai.

### Vizita me karakter studimi në komuna

Përfaqësuesët e Rrjetit të Shkollës në dhjetor të vitit 2004 në kuadër të projektit për vizita studimore në komuna ka bërë një vizitë kuventit komunal të Prizrenit. Vizita është bërë me qëllim të komunikimit të drejtpërdrejt me zyrtarin komunal për rini dhe u bë një iformim i shkurtër për punën e zyrës përkatëse dhe shërbimet tjera të cilat komuna ofron për qytetarët.

“Vizita ka ofruar një mundësi të mirë për pjesëmarrësit që të zgjerojnë njohuritë dhe konsideratën e tyre për strukturat komunale, aktivitetet dhe të drejtat e qytetarëve. Interesimi i pjesëmarrësve ishte shumë i madh dhe ata shprehën dëshirë për të vazhduar me aktivitete të ngjashme”, tha përgjegjësjë e projektit, znj. Gylser Skenderi.

### Vizitë zyrës së OSBE-së

Në vazhden e këtij aktiviteti, në prill të vitit 2005, zyra e OSBE-së dhe PRRSh-ja kanë organizuar një vizitë studimore në zyrën e OSBE-së dhe i kanë informuar nxënësit për mandatin dhe aktivitetet e OSBE-së. Vizita ka ndihmuar në dhënen e një pasqyre më të plotë sa i përket bashkëveprimit në mes të autoriteteve vendore dhe komunitetit ndërkombëtar dhe mënyrat që ata përdorin gjatë bashkëpunimit. Pjesa më e madhe e infromimit është përqëndruar në institucionet e OSBE-së dhe në aktivitetet për ngritje profesionale.

“Ndërtimi i institucioneve do të thotë mbështetja e zhvillimit të strukturave demokratike në emër të tërë shoqërisë”, shprehet z. Horst Denecke, shef i zyrës së OSBE-së në Prizren.

### Procedurat për hartimin e projekteve

Projekti nuk mund të realizohet nëse nuk është i shkruar. Duke pasur parasysh këtë fakt, zyra e OSBE-së në Prizren në fillim të këtij muaji ka organizuar një punëtori për procedurat e hartimit të projekt propozimit për anëtarët e PRRSh-së. Gjatë punës në grupe ata duhet të hartonin nga një projekt të vetin dhe ta prezentonin atë. Mësimdhënësit konsideruan këtë punëtori si një stimulim të mirë për studentët në PRRSh që ata vet të ndërmarrin më shumë aktivitete. Zyra në Prizren parashih që të ketë projektin e parë për involvimin e rinisë në punën e komunave në një të ardhme shumë të afërt.

### Të rinjtë dhe policia në komunitet

Koncepti i policisë në komunitetit bazohet në një bashkëpunim të fortë dhe të vazhdueshëm në mes të policisë dhe qytetarëve. Misioni i OSBE-së e ka filluar dhe ende mbështetë implementimin e këtij bashkëpunimi dhe bashkëveprimit.

Sipas këtij koncepti policia dhe qytetarët duhet që së bashku të bëjnë identifikimin e çështjeve të sigurisë dhe të punojnë për zgjidhjen e këtyre. Përmes involvimit të drejtpërdrejt popullsia zhvillon ndjenjen e pronësisë dhe përgjegjësisë për sigurinë e përgjithshme.

Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunim në mes të Shërbimit Policor të Kosovës dhe rinisë së Prizrenit, zyra e OSBE-së, më 10 maj, ka organizuar një vizitë studimore në tacionin lokal të SHPK-së.

“Policia është në shërbim të qytetarëve dhe punon për krijimin e një mjedisi më të sigurtë për të gjithë, pa marrë parasyshë përkatësinë etnike apo religjioze. Ata respektojnë dhe përkrahin të drejtat e njeriut”, tha z. Fatmir Kryeziu, nëpunës policor për komunitete pran SHPK-së në Prizren.



Zyra e OSBE-së në Prizren, ndihmon të rinjtë në përparimin e njohurive të tyre për institucionet lokale dhe përgjegjësitë e tyre.

Nxënësit dhe mësimdhënësit ishin të interesuar të mësonin veçanërisht për rolin e SHPK-së në parandalimin e krimeve të të rinjëve, struktura organizative e SHPK-së dhe aktivitetet e rregullta ditore.

*Njohuria e fituar përmes vizitave studimore që janë bërë në kuvendin komunal të Prizrenit, zyrën e OSBE-së dhe në stacionin e SHPK-së do të përcillet përmes Përfaqësuesve të Rrjetit të Shkollës të nxënësit tjerë në shkollat e tyre përkatëse.*

*PRRSh-ja ndihmon nxënësit e shkollave të mesme për të kuptuar më mirë institucionet e Kosovës dhe të njihen me punën dhe përgjegjësitë për të vepruar në mënyrë të hapur, transparente dhe të përgjegjshme me publikun.*

### E drejta e informimit për komunitetin rom në Prizren

Minority communities often face isolation and lack information about services and opportunities available to them. Development of quality broadcast programmes that provide information about education and other relevant issues from the political and social life has a crucial role in tackling this issue.

As a historic crossroad for traders and entrepreneurs Prizren has been a synonym of tolerance. It is considered as a centre of culture and art by different ethnic communities. In addition to Albanian, Serbian, Bosnian, and Turkish, Romani language is also spoken in the streets and other public places.

#### Programi i romëve në ‘Radio Prizreni’

Megjithatë, komuniteti rom dhe gjuha e tyre nuk janë paraqitur në mënyrë adekuate në transmetimet e radiove lokale. Për të zgjidhur këtë situatë, zyra e OSBE-së në Prizren ka mbështetur themelimin e redaksisë botuese për programin në gjuhën rome në ‘Radio Prizreni’, e cila deri më tani ka konsideruar veten si institucion shumëgjuhësor.

Redaksia botuese e sapo themeluar për programin në gjuhën rome është njëra nga burimet kryesore informative për komunitetin rom në rajon. “Qëllimi kryesor i projektit është që të ofrojë një shërbim transmetimi për komunitetin rom në gjuhën e tyre, të integrojë një redaksi të romëve dhe stafin rom në fushën e veprimtarisë të këtij stacioni të radios, dhe të avancojë shkathësitë transmetuese duke arritur standartet redaktuese adekuate, të cilat do të përshtaten me nevojat e komunitetit rom”, tha Maurizio Giachero, zyrtar për demokratizim në zyrën e OSBE-së në Prizren. “Ne gjithashtu synojmë që të zgjerojmë pozitën e ‘Radio Prizrenit’ edhe më tutje si transmetues shumëtnik dhe do të inkurajojmë zhvillimin e mediave të qëndrueshme”.

Redaksia botuese është fuqimisht e mbështetur nga menaxhimi i ‘Radio Prizreni’. “Radio Prizreni’ si transmetues i orientuar në komunitete ka për qëllim të merret me një nga sfidat kryesore të programit cilësor dhe të drejtën e informimit në gjuhën rome,” tha z. Abdullah Hoxha, rejtör i ‘Radio Prizrenit’.

#### Inegrimi i komunitetit rom

Gjatë vizitës në ‘Radio Prizreni’ dhe redaksisë së programit për komunitetin rom, ne kemi vërejtur një atmosferë pozitive pune në mes të gazetarëve të përkatësive të ndryshme etnike. Motivimi i tyre është që të identifikojnë dhe adresojnë nevojat e komuniteteve.

“Redaksia botuese e programit në gjuhën rome ka për qëllim që të shtojë bashkëpunimin në mes të grupeve të ndryshme etnike dhe të zgjerojë nivelin e tyre të kuptimit, me qëllim përfitim të të gjithëve. Me transmetimin e programeve specifike në gjuhën rome ne dëshirojmë të inkurajojmë dhe përkrahim integrimin e komunitetit tonë në shoqëri, duke ngritur vetëdijen publike, sidomos të komuniteteve tjera, për nevojat, sfidat dhe të drejtat e komunitetit rom”, tha z. Nexhip Menekshe, redaktor i programit në gjuhën rome.

Përmes programeve për ngritje të vetëdijes publike, që përfshijnë përmbajtje kulturore dhe debate me përfaqësues të komuniteteve të ndryshme për sfidat, vështësitë dhe nevojat, kjo redaksi botuese ka për qëllim të përkrahë edhe paanësinë dhe integrimin e komunitetit në shoqëri.